



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR

**RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2023 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK
TË REALIZUAR NGA
MINISTRI I SHTETIT DHE KRYENEGOCIATOR**

1. Përmbledhje ekzekutive

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori ka miratuar një (1) akt në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023. Akti i miratuar ka qenë vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 (PKIE 2023-2025)”, i cili ka qenë i kualifikuar edhe për konsultim publik sipas parashikimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Ky akt ka patur si objekt miratimin e dokumentit strategjik Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 të përgatitur nga grupet ndërinstitucionale të punës për secilin kapitull të acquis si dhe ministritë përgjegjëse për secilin kapitull të negociatave të pranimit në BE.

Nisur nga praktika e viteve të kaluara Plani Kombëtar për Integrimin Evropian ka patur si aktivitet kryesor për pjesën e konsultimit publik organizimin e takimeve publike, të hapur për çdo person të interesuar (individ, ekspert apo organizatë) në procesin e konsultimit publik të PKIE-së. Metoda e njoftimit për organizimin e takimit publik u krye nëpërmjet njoftimeve me postë elektronike.

Edhe për PKIE 2023-2025, MSHK ka njoftuar me postë elektronike të gjitha kontaktet e shoqërisë civile, ekspertëve që disponon për datën e konsultimit publik duke e konsideruar dhe si një ftesë për pjesëmarrje.

Për konsultimin publik të PKIE 2023-2025 u përdorën metodat si më poshtë:

- Konsultimi publik nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimeve publike;
- Takim për konsultimin e kapitullit “Kriteri Politik” dhe kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, me tryezën e diskutimit dhe këshillimit pranë GNPIE kapitulli 23, të ngritur në kuadër të Platformës së Partneriteti Publik për Integrimin Evropian.

2. Analiza e konsultimeve të kryera në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori ka miratuar gjithsej një (1) akt në Këshill të Ministrave për periudhën janar-qershor 2023.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Akti i miratuar gjatë kësaj periudhe është vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025”, dhe duke qenë objekt i ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” i është nënshtruar procesit të konsultimit publik.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Nuk është e aplikueshme

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

I vetmi akt i planifikuar ka qenë PKIE 2023-2025.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.122, datë 1.3.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2023–2025.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Për shkak të natyrës specifike të PKIE, situata nuk paraqet ndryshime nga viti në vit.

2.2. Metodatat e konsultimit

Konsultimi publik për PKIE 2023-2025 në regjistrin elektronik të konsultimit publik të projektakteve ishte një konsultim i hapur për çdo individ apo organizatë e interesuar për procesin e integritit Evropian për të dhënë mendim apo sugjerime mbi projektaktin.

Ministria e Drejtësisë në kuadër të procesit të konsultimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2023-2025, në bazë të metodologjisë për hartimin e këtij plani, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 113, datë 30.8.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian” si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterit Politik më datë 25 janar 2023

në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë zhvilloi procesin e konsultimit të PKIE 2023-2025 për këta kapituj nën drejtimin e Kryetares së GNPIE-së dhe Negociatore.

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)

Akti i objekt i konsultimit publik miratuar për 6-mujorin e parë të 2023, u konsultua përmes konsultimit në faqen zyrtare të konsultimit publik dhe takimit konsultativ për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterit Politik.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Në regjistrin e konsultimit publik u regjistruan dy komente. Nga takimi i mbajtur për konsultimin e PKIE 2023-2025 me tryezën e diskutimit dhe këshillimit GNPIE kapitulli 23, ka patur 3 komente nga përfaqësuesit e grupeve të interesit.

2.2.3 A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Nuk ka patur konsultime në faza më të hershme.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?

Konsultimi nëpërmjet regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik, zgjati për për 20 ditë pune sikurse kërkuar nga ligji. Përgjatë këtij afati u zhvillua dhe konsultimi në kuadër të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 113, datë 30.08.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ishte 20 ditë pune.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Gjithashtu në vitin e kaluar kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë 20 ditë pune.

2.4. Palët e interesit të përfshira

2.4.1 Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve në 6 mujorin e parë? Sa eksperte ishin në tryeza?

Nuk ka patur palë interesi të jashtme në grupet e punës brenda MEPJ-së për hartimin e PKIE 2023-2025.

PKIE është e ndarë në kapitullin “Kriteri Politik” dhe “Kriteri ekonomik” si dhe pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve negociues. Procesi i planifikimit të PKIE-së kryhet nga institucionet përgjegjëse/lider të kapitujve. Gjatë gjithë procesit të planifikimit MSHK koordinon punën me GNPIE-të e të 33 kapitujve për hartimin e PKIE-së.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)

Nuk ka patur anëtarë të jashtëm jo-qeveritar pjesëmarrës në hartimin e PKIE.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?

6 aktorë interesi morën pjesë në konsultimet e hapura për PKIE 2023 – 2025, ndërsa 5 prej tyre dhanë komente.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Të 5 pjesëmarrësit në proceset e konsultimit publik të PKIE 2023-2025 kanë qenë përfaqësues të personave juridik si shoqata biznesi, shoqëri civile dhe person fizik.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara qëndron në të njëjtin trend.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

Rezultojnë pesë (5) komente të gjeneruara.

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Nga konsultimi përmes RENJK janë përcjellë 2 komente, dhe 3 nga takimi konsultativ.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Komentet ishin të një natyre të përgjithshme dhe nuk u materializuan në terma konkrete propozimesh. Rrjedhimisht u refuzuan nga pikëpamja teknike.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Situata paraqitet me të njëjtin trend.

2.5.4 Cilat janë përfundimet/rezultatet kryesore nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit

Procesi i konsultimit publik ka ardhur duke u përmirësuar por sigurisht për natyrën specifike të PKIE-së trendi paraqitet me të njëjta ritme.

2.5.5 Ndarja e praktikave më të mira nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit

Përdorimi i disa mënyrave të konsultimit ka shtuar mundësinë e hartimit të një politike më efikase në këtë rast.

2.6. Rezultatet e raporteve të konsultimeve

2.6.1 Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?

2.6.2 Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?

Për procesin e konsultimit publik të PKIE 2023-2025 është përgatitur raport individual mbi konsultimin publik të aktit dhe është publikuar në regjistrin elektronik të konsultimit publik.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator për gjashtë mujorin e parë për vitin 2023 sikurse është cituar dhe më lart ka konsultuar gjithsej një akt. Nisur nga kërkesat e ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", sugjerojmë vlerësimin maksimal 8 për procesin e kryer të konsultimit publik për aktin.

3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces duke marrë në konsideratë dhe natyrën teknike të aktit.